



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2017 – Numri: 248

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 20 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 58, datë 29.12.2017	13479
Për miratimin e rregullores së inspektimit dhe të monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit në sektorin Ujësjetës-Kanalizime (UK).....	13479

**VENDIM**

Nr. 58, datë 29.12.2017

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
INSPEKTIMIT DHE TË MONITORIMIT
TË VEPRIMTARISË SË OFRUESVE TË
SHËRBIMIT NË SEKTORIN
UJËSJELLËS-KANALIZIME (UK)**

Në zbatim të nenit 14, germa “e”, “f”, “h”, “i”, “j”, të neneve 23, 24, 26, 27, 28, 29 dhe 32/1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e inspektimit dhe të monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit në sektorin ujësjellës-kanalizime (UK), sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.

2. Ngarkohen të gjitha drejtoritë e ERRU-së për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi i Komisioni Kombëtar Rregullator nr. 01, datë 6.1.2012, “Për miratimin e rregullores për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe marrjen e vendimit për dënimin e kundërvajtjeve administrative në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit, dhe të përpunimit të ujërave të ndotura”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

RREGULLORE**E INSPEKTIMIT DHE E MONITORIMIT
TË VEPRIMTARISË SË OFRUESVE TË
SHËRBIMIT NË SEKTORIN
UJËSJELLËS-KANALIZIME (UK)****KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Misioni i ERRU-së**

Të sigurojë që, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme për kryerjen e shërbimeve, me një çmim të arsyeshëm dhe që ato vetë të jenë të qëndrueshme financiarisht.

Neni 2**Përkufizimet**

Termet e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

Neni 3**Baza ligjore**

1. Kjo rregullore është përgatitur në bazë të legjislacionit specifik të mëposhtëm:

a) Ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar;

b) Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;

d) Ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Kjo rregullore mban parasysh edhe aktet nënligjore në zbatim të ligjeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni.



KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 4 Fusha e veprimtarisë

Fusha e veprimtarisë së ERRU-së janë të gjitha veprimtaritë private dhe shtetërore në sektorin ujësjellës-kanalizime, duke përfshirë, por jo duke i kufizuar të drejtat e personave fizikë e juridikë, si dhe të organeve shtetërore qendrore e vendore.

Neni 5 Funksionet e ERRU-së

1. Vlerëson cilësinë e shërbimit të UK-së në përgjithësi ose për aspekte të veçanta në sektorin UK (funksion vlerësues);

2. Kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së shoqërive UK, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (funksion kontrollues), përkatësisht:

2.1 Të kontrollojë zbatimin e kushteve të licencës, dokumentacionin e të licencuarit dhe çdo të dhënë tjetër për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit me kushtet e licencës, rregullat dhe standardet në fuqi;

2.2 Inspekton dokumentacionin e veprimtarisë, ambientet dhe pajisjet e të licencuarit;

2.3 Shqyrton ankesat e ndryshme nga konsumatorët;

2.4 Kontrollon dokumentacionin mbi kontrollin periodik të cilësisë së ujit të pijshëm;

2.5 Monitoron treguesit kryesorë të performancës;

3. Jep këshilla për përmirësimin e cilësisë dhe zbatimit të kushteve e standardeve teknike të miratuara (funksion këshillues), përkatësisht këshillon;

3.1 Për politikën, rishikimin e strategjive dhe vendimmarrjeve në fushën e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve;

3.2. Shoqërive UK për përmirësimin e shërbimit;

3.3 Praktika të suksesshme të shoqërive UK dhe individëve nëpërmjet raporteve, gjithashtu në mënyrë të posaçme, nëpërmjet faqes së internetit ose botimeve;

4. Informon/raporton për gjetjet e tij (funksion informues/raportues), përkatësisht me anë të:

4.1 Raporteve të inspektimit, letrave informuese, raportit vjetor dhe raportit të performancës;

4.2 Publikimit të raporteve e inspektimit në faqen e internetit;

4.3 Organizimit të takimeve, seminareve, konferencave për të informuar grupet e interesit rreth gjetjeve të tij.

KREU III INSPEKTIMI/MONITORIMI

Neni 6 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë procedurat dhe parimet bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në rastet kur Enti Rregullator i Ujit (ERRU) ushtron kontroll të veprimtarisë ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

2. Kjo rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve të ERRU-së, në kuadër të përmbushjes së përgjegjësive gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, si dhe të gjitha palëve, që janë subjekt i inspektimit dhe/ose i monitorimit.

Neni 7 Metodologjia e inspektimit/e monitorimit

1. Inspektimet me karakter kombëtar, rajonal ose për çdo shoqëri të veçantë UK përcaktohen në planin vjetor të punës së ERRU-së;

2. ERRU-ja, gjatë vitit, planifikon me përparësi inspektime/monitorime, në:

a) UK të cilat kanë dëshmuar dobësi të theksuara në përmbushje të parashikimeve të ligjit nr. 8102 dhe akteve ligjore në fuqi (ushtrimi i veprimtarisë pa licencë, moszbatimi i kushteve të licencës, ushtrimi i veprimtarisë me tarifa të pamiratuara nga ERRU-ja, moszbatimi i vendimeve të Entit Rregullator për tarifën, detyrime të pashlyera të pagesës rregullore etj.);

b) UK të cilat kanë dëshmuar dobësi të theksuara në inspektime të mëparshme;

c) UK të cilave u janë lënë detyra për t'u përmirësuar;

d) UK për të cilat ka pasur më shumë ankesa nga konsumatorët;

3. Inspektori e vlerëson veprimtarinë e tij përmes:



- a) Vëzhgimeve të drejtpërdrejta;
- b) Intervistave me drejtuesit e UK-së, punonjës e shoqërisë, përfaqësues të komunitetit etj.;
- c) Pyetësorëve dhe anketave;
- d) Shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar të shoqërisë.

Neni 8

Objekti i inspektimit/i monitorimit

1. Objekti i inspektimit/i monitorimit do të përfshijë kryesisht:

- a) Licencën dhe kushtet e zbatimit të saj;
- b) Zbatimin e tarifave të miratuara nga ERRU-ja;
- c) Performanca tekniko-ekonomike e shoqërisë;
- ç) Shlyerja e pagesës rregullatore;
- d) Çdo veprimtari tjetër.

Neni 9

Parimet e inspektimit

Organi i inspektimit, në mënyrë që të zbatojë një inspektim sa më efektiv, do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. Parimet e përgjithshme:
 - a) Trajtim i drejtë dhe jodiskriminues i të gjitha subjekteve, gjatë aktiviteteve të inspektimit dhe/ose të monitorimit;
 - b) Sigurimi i konfidencialitetit të informacionit, të dhënave dhe dokumenteve të siguruar gjatë aktiviteteve të inspektimit dhe/ose të monitorimit, përveç rasteve të parashikuara me ligj;
 - c) Paanshmëria gjatë kryerjes së inspektimit dhe/ose të monitorimit, vlerësimit të rezultateve dhe hartimit të akteve përkatëse;
 - d) Parandalimi i çfarëdolloj ndërhyrjeje, qoftë nga brenda apo jashtë ERRU-së, që mund të ndikojë në ndershmëri ose paanshmëri;
 - e) Trajtimi me kujdes dhe përgjegjshmëri i secilës fazë të aktivitetit të inspektimit dhe të monitorimit;
 - f) Pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të inspektimit dhe të monitorimit, pavarësisht parimeve të listuara në këtë nen.

2. Parimi i pavarësisë së inspektimit, sipas të cilit organi inspektues, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor, është plotësisht i pavarur në kryerjen e detyrës së tij.

3. Parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit, sipas të cilit:

a) Në kryerjen e inspektimit, organi inspektues kryen veprimet e inspektimit në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në veprimtarinë e subjektit të inspektimit vetëm për atë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit;

b) Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, organi vendimmarrës, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo të masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit.

Neni 10

Drejtues i ekipit të inspektimit

1. Drejtuesi i ekipit të inspektimit:

- a) Përgatit platformën e inspektimit e cila miratohet nga kryetari i ERRU-së;
- b) Harton planin e zhvillimit të inspektimit;
- c) Organizon zhvillimin e inspektimit;
- d) Drejton hartimin e raportit të inspektimit;

Neni 11

Autorizimi

1. Inspektimi kryhet në bazë të autorizimit përkatës.

2. Kryetari i ERRU-së autorizon nëpunës të specializuar të administratës së vet apo persona të tjerë të specializuar, të certifikuar nga institucionet përkatëse, për të realizuar këtë inspektim/monitorim, në përputhje me kriteret dhe rastet e parashikuara në ligj.

3. Nëpunësit e specializuar përzgjidhen nga strukturat e administratës së ERRU-së dhe duhet të mbulojnë fushat përkatëse të objektit apo çështjes për të cilën kryhet inspektimi/monitorimi.

Neni 12

Përmbajtja e autorizimit

1. Në autorizimin e inspektimit përcaktohen të paktën këto elemente:

- a) emri apo emërtimi dhe adresa e subjektit të inspektimit;
- b) objekti i inspektimit;



- c) data e lëshimit;
- d) identiteti i nëpunësve të autorizuar për të kryer inspektimin;
- e) kur ka, identiteti i personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse;
- f) kohëzgjatja, në ditë, për kryerjen e inspektimit (opsionale);

g) të dhënat e identifikimit, pozicionit dhe nënshkrimin e personit që ka lëshuar autorizimin.

2. Adresa e subjektit që i nënshtrohet inspektimit është adresa e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi që kanë shoqëritë tregtare. Kur subjekti që i nënshtrohet inspektimit ka më shumë se një adresë për ushtrimin e aktivitetit të tij, autorizimi i shtrin efektet e tij edhe në këto adresa, pavarësisht nëse janë ose jo të regjistruara sipas legjislacionit përkatës.

Neni 13

Personat e autorizuar

1. Inspektimi/monitorimi kryhet nga punonjësit e përcaktuar në autorizimin e inspektimit.

2. Zëvendësimi i një anëtarit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit mund të bëhet vetëm me vendim të veçantë të kryetarit të ERRU-së, që i njoftohet pa vonesë subjektit të inspektimit/monitorimit, përpara fillimit të veprimeve nga anëtarit i ri.

3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, punonjësi identifikohet me dokumentin përkatës të punonjësit të autorizuar.

Neni 14

Mbështetja e veprimeve të inspektimit

1. Grupi i inspektimit, për përcaktimin e fakteve e të rrethanave të nevojshme për marrjen e një vendimi, mund të kërkojë ndihmë të specializuar apo informacione dhe ose të dhëna të tjera të nevojshme nga nëpunës, organe publike apo ekspertë e subjekte të certifikuara private.

2. Nëpunësit, organet publike apo ekspertë e subjekte të certifikuara private, përmendur në pikën 1 të këtij neni, gjatë inspektimit nuk kanë të drejtat e përcaktuara nga ligji dhe kjo rregullore dhe nuk mund të marrin vendime procedurale apo përfundimtare për inspektimin. Sidoqoftë, ata kanë detyrimin të mos përhapin a të përdorin të dhënat personale dhe ato që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të

subjektit të inspektimit a të personave të tjerë të përfshirë, që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi dhe me të cilat njihen gjatë inspektimit.

Neni 15

Njoftimi i inspektimit/i monitorimit

1. Platforma e inspektimit i njoftohet përfaqësuesit të subjektit të inspektimit të paktën 5 (pesë) ditë përpara. Në rast të refuzimit të marrjes së saj apo mosgjetyes së personit përfaqësues, inspektimi do të realizohet dhe ky fakt pasqyrohet në raportin përfundimtar.

2. Njëkohësisht me njoftimin e mësipërm, në çdo rast, grupi i inspektimit, përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, informon verbalisht, përfaqësuesin e subjektit që inspektohet për objektin e inspektimit e për të drejtat dhe detyrimet e tij sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

3. Në rast se subjekti refuzon inspektimin ose pengon zhvillimin e inspektimit, atëherë ERRU-ja bën kallëzim penal ndaj shoqërisë.

Neni 16

Vendi i inspektimit

1. Vendi i inspektimit, pavarësisht adresës së përcaktuar në autorizimin e inspektimit, mund të jetë:

a) kudo ku kryen veprimtarinë e tij subjekti që inspektohet dhe ndodhen faktet që lidhen me qëllimin e inspektimit;

b) në zyrat e organit inspektues, nëse nga natyra e inspektimit është i mundur realizimi i qëllimit të tij.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, subjekti i inspektimit ftohet, nëpërmjet njoftimit paraprak, të paraqitet në zyrat e Entit Rregullator të Ujit, ku njëkohësisht, subjektit që inspektohet mund t’i kërkohej të paraqesë dokumente, sende apo të dhëna të tjera, të nevojshme për kryerjen e inspektimit në zyrat e organit inspektues.

Neni 17

Koha për kryerjen e inspektimit

Veprimet e inspektimit zhvillohen në çdo kohë gjatë orarit zyrtar të punës, por nuk mund të zgjasin më shumë se 4 orë mbi kohën normale të punës.



Neni 18

Të drejtat e subjektit të inspektimit

Subjekti i inspektimit ka këto të drejta:

1. Të kërkojë të njihet me autorizimin e inspektimit para fillimit të saj;
2. Të kërkojë identifikimin e kryetarit të grupit të inspektimit dhe anëtarëve të tjerë nëpërmjet kartës së punonjësit shtetërorë;
3. Të jetë prezent dhe të ndjekë, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, të gjitha veprimet e inspektimit;
4. Të paraqesë, me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me inspektimin, apo të paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet përkatëse ku i mbështet ato;
5. Të kërkojë të njihet dhe t'i njoftohet raporti paraprak, raporti përfundimtar i inspektimit, si dhe vendimi i KKRR-së;
6. Të paraqesë pranë KKRR-së kontestimet e tij për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e hetimit dhe për vendimin që synohet të merret nga organi publik.

Neni 19

**Detyrimet e subjektit të inspektimit/
të monitorimit**

Përveç sa parashikohet nga ligji, subjekti i inspektimit ka këto detyrime gjatë veprimtarisë së inspektimit:

1. Të ketë, të paktën, një punonjës ose një person të autorizuar prej tij, në çdo kohë, në vendin/ambientin ku do të kryhet inspektimi/monitorimi, i cili ka të njëjtat të drejta dhe detyrime ndaj organit inspektues.
2. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit. Mungesa e bashkëpunimit vlerësohet në raportin e grupit të inspektimit dhe në vendimin përfundimtar, bashkë me provat e tjera.
3. Të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorëve, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë, si dhe t'u ofrojë inspektorëve qasje në pajisjet dhe/ose infrastrukturën në posedim apo administrim nga subjekti i inspektimit.
4. Të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e

konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektorët, duke respektuar edhe afatin kohor të përcaktuar për realizimin e inspektimit.

5. Të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmimeve nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektorët.

Neni 20

Të drejtat e grupit inspektimit

1. Të hyjnë dhe të inspektojnë godinat, mjediset, objektet, mjetet, ku apo nëpërmjet të cilave ushtron veprimtarinë subjekti i inspektimit, si dhe të inspektojë instalimet, pajisjet, makineritë, produktet, sendet, përbërësit dhe çdo send tjetër të lidhur me veprimtarinë, objekt inspektimi, kudo ku ato ndodhen.

2. Të inspektojnë dhe të kërkojnë të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet me gojë dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti i marrë nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar. Kjo pikë zbatohet edhe për dokumentet e ruajtura në trajtë elektronike, regjistrimet elektronike e audiovizive apo të çdo lloj teknologjie tjetër.

3. Të kryejnë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjedisëve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, objekteve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave përbërësve dhe çdo sendi tjetër që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.

4. Të bëjnë matjet e nevojshme për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

5. Të kryejnë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit.

6. T'i kërkojnë subjektit të inspektimit apo punëmarrësve të tij të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar inspektimin.

Neni 21

Detyrimet e grupit të inspektimit

Përveç sa parashikohet ndryshe nga ligji, inspektorët kanë këto detyrime:

1. Para fillimit të inspektimit, të prezantohen me anë të dokumentit të identifikimit të institucionit.



2. T'i paraqesin subjektit të inspektimit autorizimin përkatës të inspektimit.

3. Të demonstrojnë etikë dhe sjellje profesionale në vendin dhe gjatë procesit të inspektimit.

4. Të ruajnë informacionet konfidenciale dhe sekretet tregtare të marra gjatë inspektimit, përveç atyre ligjërisht të autorizuar dhe, gjithashtu, të shmangin përdorimin e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për përfitim personal apo për përfitim të palëve të treta.

Neni 22

Mbajtja e procesverbalit paraprak

1. Inspektorët që kryejnë inspektimin mbajnë procesverbalin e inspektimit paraprak në vend. Procesverbalin mbahet në dy kopje, të cilat nënshkruhen nga inspektorët, si dhe përfaqësuesi i subjektit të inspektimit. Procesverbalin, si rregull, mbahet në vendin e inspektimit dhe i njoftohet, në përfundim të inspektimit, subjektit të inspektimit nëpërmjet dorëzimit personal në vend. Procesverbalin mund të mbahet edhe në zyrat e ERRU-së, kur kundërvajtja lidhet me detyrime të subjektit për të kryer pagesa, për të paraqitur apo për të tërhequr dokumentacion, verifikimi dhe konstatimi i së cilës bëhet kryesisht nga ERRU-ja.

2. Procesverbalin përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të konstatuara gjatë inspektimit.

3. Subjekti që inspektohet ka të drejtë të paraqesë, menjëherë, pretendimet e veta lidhur me inspektimin.

4. Në rast se gjykohet e arsyeshme, për shkak të administrimit të një apo disa provave, të cilat nuk mund të administrohen në vend, inspektorët mund t'i lënë një afat kohor subjektit që inspektohet që të paraqesë pretendimet e veta me shkrim, së bashku me provat në fjalë. Ky fakt pasqyrohet në procesverbal, së bashku edhe me afatin e caktuar prej inspektorëve, afat ky që, në çdo rast, nuk mund të jetë më i shkurtër se 5 (pesë) ditë. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes.

5. Në rast se subjekti i inspektimit refuzon të nënshkruajë procesverbalin, ky fakt shënohet në procesverbal. Dorëzimi i procesverbalit të përfaqësuesit të subjektit të inspektimit, menjëherë në përfundim të inspektimit dhe në vendin ku është kryer inspektimi, konsiderohet si njoftim i procesverbalit. Kur kjo nuk mund të realizohet, njoftimi kryhet sipas mënyrave të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 23

Raporti i inspektimit/i monitorimit

Raporti i inspektimit përshkruan me argumente:

a) Si drejtohet, administrohet dhe menaxhohet shoqëria UK;

b) Nëse veprimtaria e saj është konform kushteve të licencës;

c) Zbatimi i tarifave të miratuara nga ERRU-ja;

d) Si është në përgjithësi performanca e shoqërisë UK, çfarë performon mirë dhe çfarë duhet të përmirësojë;

f) Sa është përmirësuar shoqëria UK kundrejt inspektimit të mëparshëm ose sa ka realizuar rekomandimet që një ekip inspektues i ka lënë shoqërisë.

KREU IV

SANKSIONET DHE MASAT

Neni 24

Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar

1. Grupi i inspektimit i dorëzon raportin përfundimtar KKRR-së dhe subjektit të inspektuar brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i inspektimit/i monitorimit. Në rastet kur konstatohen shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, grupi i inspektimit i propozon KKRR-së marrjen e masës përkatëse sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

2. KKRR-ja, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së raportit përfundimtar, njofton subjektin e inspektuar se po përgatitet për marrjen e një vendimi, në të cilin specifikohet afati në jo më pak se (5) pesë ditë nga data e njoftimit, brenda së cilit subjekti mund të bëjë paraqitjen e kundërshtimeve mbi masën e propozuar.

3. KKRR-ja vendos brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve dhe vendimi përfundimtar i njoftohet subjektit sipas ligjit.



Neni 25

Përmbajtja e vendimit për kundërvajtjen

Në vendimin për kundërvajtjen administrative jepen:

- a) Organi që ka nxjerrë aktin;
- b) Subjekti i inspektuar;
- c) Shpjegimi i përmbledhur i fakteve dhe i provave ku mbështetet vendimi;
- d) Shkelja e kryer, duke referuar në dispozitën ligjore ku mbështetet vendimi;
- e) Masat administrative përkatëse;
- f) Cilësimi si titull ekzekutiv për masën e gjobës;
- g) Datën e hyrjes në fuqi;
- h) Hapat e tjerë që do të ndjekë ERRU-ja;
- i) Të drejtën për ankim për procedurën e ndjekur.

Përveç të dhënave të përmendura në paragrafin e parë të këtij neni, në vendim mund të përfshihen edhe të dhëna të tjera që KKRR-ja e sheh të arsyeshme.

Neni 26

Ankimi gjyqësor

1. Kundër vendimit përfundimtar të KKRR-së dhe brenda afateve ligjore, shoqëria ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën kompetente.

KREU V

FORMULARËT, PUBLIKIMI, SHFUQIZIME DHE HYRJA NË FUQI

Neni 27

Formularët

Formularët bashkëlidhur këtij vendimi janë pjesë përbërëse e tij, në emërtesat përkatëse, si më poshtë vijon:

1. Autorizimi i inspektimit;
2. Procesverbali i inspektimit në vend.

Neni 28

Publikimi

Kjo rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj, publikohet në faqen zyrtare të ERRU-së në internet, pas miratimit të saj.

Neni 29

Shfuqizime

1. Rregullorja nr. 01, datë 6.1.2012, “Për procedurat e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe marrjen e vendimit për dënimin e kundërvajtjeve administrative në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit, dhe të përpunimit të ujërave të ndotura”, shfuqizohet.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga ERRU-ja.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Datë ____.

AUTORIZIM INSPEKTIMI

Bazuar në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në rregulloren e inspektimit të miratuar:

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit:

Personat e autorizuar për të kryer inspektimin:

1. _____ Funkzioni: _____

2. _____ Funkzioni: _____

Kohëzgjatja e parashikuar e inspektimit: _____

Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi (adresa/t): _____

Njoftim paraprak i platformës së inspektimit subjektit të inspektimit: Po Jo **KRYETARI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Datë ____.

PROCESVERBAL INSPEKTIMI**I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME**

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Njoftim paraprak lënë subjektit: Po Jo **II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT****1. Detyra të përcaktuara nga inspektimi i mëparshëm:**

2. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqiteni:

Dokumente të paraqitura

Nr.	DOKUMENTI DHE PËRSHKRIMI	NR. I FLETËVE
1		
2		

Materiale, pajisje, Software, sende të paraqitura

Nr.	SENDI DHE PËRSHKRIMI	COPË
1		
2		

3. Dokumente të marra

Nr.	DOKUMENTI I MARRË DHE PËRSHKRIMI	NR. I FLETËVE
1		
2		

**4. Gjetjet e konstatuara**

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Po Jo

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, neni _____, pika _____.

Masa urgjente:Po Jo **5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrat e ERRU-së**Po Jo

Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit _____, në datën _____._____, ora _____, të paraqitet në adresën _____, për vazhdimin e procedurës së inspektimit.

6. Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit

Për faktet dhe rrethanat e konstatuara të paraqitura në këtë procesverbal, subjekti mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose me gojë pranë ERRU-së, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të këtij procesverbali.

Me përfundimin e këtij afati, grupi inspektimit do t'i propozojë KKRR-së marrjen e masës përkatëse.

III. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr.____, datë _____._____, të nenit/eve _____, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ:

- a) _____;
- b) _____.

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korigjuar:

IV. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt në 3 (tri) kopje të njëjta, sot, në datën _____._____. dhe, pasi lexohet, nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët e ERRU-së

Personi i autorizuar nga subjekti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë